

07.10.2021
Ora 13:06

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për rishqyrtimin administrativ të shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, në lidhje me zhvillimin e fushatës elektorale në ambjentet e Bibliotekës “Misto Treska”, Tiranë.”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Të tjerë:**
 1. Organizata “Qëndresa Qytetare” **R. Xhemollari, M. Qiraxhi**


Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e ankimit administrativ të organizatës “Qëndresa Qytetare”. Kemi prezent përfaqësues të organizatës.

Z. R. Xhemollari: Po Rigels Xhemollari dhe Migen Qiraxhi.

Z. M. Qiraxhi: Migen Qiraxhi, përfaqësues i organizatës.

Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit! Atëherë ne kemi marrë një kërkesë nga ana juaj sipas së cilës, aktiviteti i kandidatit për deputet të Partisë Socialiste, zotit Bllako nuk është zhvilluar në bibliotekën “Misto Treska”, por është zhvilluar në bibliotekën “Moikom Zeqo”, kështu?

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.10.2021*


Z. R. Xhemollari: Meqenëse janë dy kandidatë, për kandidatin Skëndo vazhdon të mbetet “Misto Treska”, ndërsa....

Z. I. Celibashi: Po, po dakord! Keni ndonjë deklaram tjetër shtesë atyre të mëparshme, në lidhje me këtë çështje?

Z. R. Xhemollari: Në fakt kemi vetëm diçka. Në vijim të seancës paraardhëse kemi një provë për të depozituar. Është kandidatja Skëndo, e cila është në ambientin e bibliotekës “Misto Treska” dhe ka vendosur maskën me logon dhe sloganin e Partisë Socialiste në zgjedhje. Një element ky, i cili besoj se mund të jetë një provë shumë e mirë që i vesh elementin elektoral takimit, si edhe kemi dhe deklaratën e kryetarit të Bashkisë në postimin e tij në Facebook, ku thotë se “Kletina, Bora, Fredi dhe Elio (që janë të gjithë emra kandidatësh) e shumë goca dhe çuna fantastikë janë pjesë e skuadrës fituese të Tiranës, që e duan vendin dhe duan të punojnë për të”. Pra është postimi i videos së këtij, në qoftë se më ndihmon dikush nga stafi për t’ju vendosur në dispozicion.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Atëherë ne po i administrojmë edhe këto si prova. Ndërkohë, vendosim që të dyja këto çështje, meqenëse kanë qenë në të njëjtin kërkim, t’i ndajmë si shqyrtime. Pra, do të jenë dy shqyrtime të veçanta, respektivisht për aktivitetin e zhvilluar nga kandidatja Skëndo në bibliotekën “Misto Treska” dhe shqyrtim më vete për ankimin mbi aktivitetin e zhvilluar nga kandidati Bllako në bibliotekën “Moikom Zeqo”. Atëherë, meqenëse kemi këto dy ndryshime në reflektim dhe të kërkesës suaj dhe të kërkesës për administrimin e provave që ju sapo paraqitët, po mbyllim këtu për sot këtë seancë për shqyrtim dhe

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.07.10.2021***

do të vazhdojmë një ditë tjetër, të cilën do t'jua njoftojmë. Seanca mbyllet,
faleminderit dhe ditën e mirë!

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***

